



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Anglisht”
Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Benita Stavre

Prof.As.Dr Leonard Danglli

Dhjetor / 2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bsc në “Anglisht”

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Anglisht
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 199, datë 16.05.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 631, datë 12.12.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 50, datë 10.07.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	55 studentë (për të tre vitet akademike)
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Bachelor në “Anglisht” ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Fakulteti i Shkencave Shoqërore të “Albanian University”. Kjo njësi bashkëpunon gjithashtu edhe me njësi të tjera, të këij Fakulteti, si Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, Departamentin e Shkencave Politiko- Administrative, si dhe me institucione të tjera arsimore dhe joarsimore që operojnë në tregun e punës, të cilat mbulojnë praktikën profesionale (kryesisht në fushën e mësuesisë).

Programi përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë bazë që i formojnë ata si profesionistë dhe mësues të gjuhës angleze. Kurrikula e programit është e strukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 180 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në tre vite akademike. Programi ofron kualifikim të nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i përgatit të diplomuarit në të për të përvijuar studimet në programe të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë, përkthimit dhe studimeve të specializuara gjuhësore.

Programi është liçensuar me Urdhër nr. 199, dt 16.05.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Akreditimi i parë me VKA nr. 178, dt.07.07.2016 u kalua me kusht. Programi rikaloi procesin e akreditimit në 07.10 2017, në përfundim të të cilit Bordi i Akreditimit i dha akreditim 3- vjeçar me Vendim VBA Nr. 50, dt.10.07.2017. Rekomandimi i bërë në këtë akreditim ishte parashikimi i rritjes së numrit dhe kualifikimeve të stafit akademik me kohë të plotë, me qëllim përmirësimin e mbulimit të ngarkesës mësimore të stafit aktual si në numër lëndësh, ashtu edhe nga pikëpamja cilësore. Në përfundim të procesit aktual të vlerësimit të jashtëm, grupi i ekspertëve gjykon se ky rekomandim është plotësuar.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 50, datë 10.07.2017

1. Institucioni duhet të parashikojë rritjen në numër dhe kualifikime të stafit akademik efektiv për të përmisuar mbulimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik aktual si në numër lëndësh ashtu dhe nga pikpamja cilësore;

II. Plotësimi nga Institucioni

Rekomandimi është përmbushur plotësisht, pasi bazuar në të dhënat e tabelave të depozituara nga IAL për 3 vitet e fundit akademike 2017-2020 konstatojmë se në realizimin e programit Bachelor në “Anglisht”, DEA angazhon 9 staf akademik me kohë të plotë (6 Dr., 1 Dr.proc, 2 Msc.) dhe 5 staf akademik me kohë të pjesshme (1 Akademik i Asociuar, 4 Doktorë shkencash) [3, tab. 2]. Nga 14 pedagogë gjithsej që mbulojnë lëndët/modulet e programit 7 kanë kualifikim në gjuhën angleze, 3 në gjuhën shqipe, 1 në gjuhën frënge, 2 në psikologji dhe 1 në filozofi/sociologji [89]



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të programit Bachelor në “Gjuhë angleze” filloi me hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm nga një grup prej katër anëtarësh prej të cilëve një student, i ngritur me propozim të Departamenti të Edukimit dhe Anglishtes dhe me miratim të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore [4]. GVB organizoi ndarjen e punës për mbledhjen e dokumentacionit dhe hartimin e raportit, në koordinim me takimet me stafin akademik, sekretaritë mësimore dhe zyrat në mbështetje të studentëve dhe veprimtarisë akademike në institucion [Tak.2].

Raporti i vlerësimit të brendshëm është i shoqëuar nga një dosje prej 83 evidencash, nga të cilat 23 janë programet lëndore; pjesa tjetër është dokumentacion që lidhet me kuadrin ligjor të njësisë, marrëveshjet institucionale, sigurimi i brendshëm i cilësisë, të dhëna për studentët dhe stafin akademik. Një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit të dosjes është në formën e dokumentit standard, jo praktikës/shembullit real të aplikuar në njësi. Raporti është kryesisht konstatues dhe i përgjithshëm. Fjalët dhe strukturat gjuhësore të kriterëve standarde rimerren në pjesën deskriptive, pa arritur një analizë të plotësisë të këtyre standardeve. Raporti nuk hyn në brendi të funksionit të programit të studimit dhe në të gjendet edhe ndonjë fjali si “objektivat adresojnë funksionimin e institucioneve ekonomike, bankare dhe financiare [RVB, fq.5], ndërkohë që objektivat e programit në fjalë qëndrojnë larg këtij fokusi.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Leonard Danglli, dhe Dr. Benita Stavre. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Vizita në institucion u krye në dy ditë, dt. 7-8 tetor 2020. Gjatë saj GVJ organizoi takime me dekanin dhe përgjegjës të departamentit, grupin e vlerësimit të brendshëm dhe NJBSC, stafin akademik dhe studentët, stafin administrativ në shërbim të studentëve (Zyra e karrierës dhe alumni dhe Zyra e koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve), përfaqësues të Zyrës së zhvillimit të kurrikulave, Zyrës së kërkimit shkencor dhe botimeve akademike dhe Zyrës së Burimeve njerëzore. Gjatë vizitës GVJ vizitoi gjithashtu ambientet në dispozicion të mësimdhënies dhe të nxënësve në këtë program studimi, sekretaritë mësimore, laboratorin e TIK dhe bibliotekën e Fakultetit. GVJ kërkoi gjithashtu edhe nëntë dokumente shtesë gjatë vizitës, kryesisht të karakterit praktik dhe analitik. Pas vizitës në institucion, GVJ krijoi ide më të qarta në lidhje me përgjegjësitë, procedurat, organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të tij dhe arriti në konstatimet e mëposhtme, të hartura në formën e këtij raporti të vlerësimit të jashtëm.

Paragraf përmbledhës FUSHA 1: Ofrimi i programeve të studimit

Programi përputhet me zhvillimin strategjik të njësisë dhe institucionit. Ai synon formimin e gjithanshëm të specialistëve dhe mësimdhënësve të gjuhës angleze. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit përputhet me atë të njësisë që e ofron. Kjo e fundit ka kapacitetet e duhura njerëzore për ta mirëmenaxhuar këtë program. Objektivat e përgjithshme dhe specifike të programit nuk janë hartuar qartë. Programi ka një prirje të theksuar ndaj formimit të mësuesve të gjuhës angleze, ndërkohë që ky formim u njihet vetëm programeve të ciklit II (Ligji 80/2015, neni 83). Për mbarëvajtjen e këtij programi DEA bashkëpunon edhe me njësi dhe zyra të tjera në institucion, si dhe me institucione të tjera (kryesisht arsimore) brenda vendit. Departamenti ka nevojë të rrisë gamën e bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë, me qëllim përmirësimin e ofertës së tij akademike.

Paragraf përmbledhës FUSHA 2: Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit të ciklit të parë bachelor

Programi synon nivel 6 të Kornizës shqiptare të kualifikimeve. Kurrikula e tij organizohet me 180 ECTS, në tre vite akademike. Rregullorja e programit reflekton kuadrin ligjor të mbarëvajtjes së tij. Plani mësimor përmban gjithë elementët e nevojshëm të aktiviteteve mësimore të parashikuara në kurrikul. Plani mësimor reflekton një ndarje të cunguar të krediteve në disfavor të lëndëve të specialitetit të gjuhës angleze sipas përshkrimit dhe rekomandimeve të bëra në Standardin II.1 dhe II.4 të këtij raporti. Plani mësimor nuk paraqet mundësi për studime të avancura, ose krahasuese në këtë fushë akademike. Duke qenë se lëndët përbërëse janë të gjitha me ngarkesë 6-8 ECTS, ato nuk lejojnë profilizimin e mëtejshëm të njohurive bazë që ofrojnë. Në kurrikul mungojnë lëndë të studimit diakronik të gjuhës angleze, të studimit të thelluar të gramatikës dhe leksikut të saj, lëndë apo module që fokusohen në stilin e të shkruarit të gjuhës, lëndët që ofrojnë njohuri mbi lidhjen gjuhë-kulturë/sociolinguistikë kanë janë thujse sfumuar nën profilizime të pastra historike, sociologjike, dhe pedagogjike të lëndëve të sipërpërmendura. Në përgjithësi, rekomandohet ulja/ndarja e balancuar e ngarkesës së krediteve në lëndët aktuale dhe shtimi i profileve të moduleve që ofrojnë formim të specializuar dhe profesional në gjuhën angleze (edhe brenda profilit të së njëjtës lëndë). Gjithashtu rekomandohet që lëndët e profilit psiko-pedagogjik të kalojnë si lëndë me zgjedhje ose të zëvendësohen nga lëndë të karakterit gjuhësor (një gjuhë e dytë e huaj, ose anglishte me qëllime specifike). Departamenti duhet të rishikojë profilizimin e praktikës profesionale vetëm në institucione arsimore, me qëllim shtimin e mundësive të praktikës si përkthyes/ interpret, pranë institucioneve me të cilat njësia bashkëpunon tashmë.

Paragraf përmbledhës FUSHA 3: Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat

Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira. Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit

mësimor e shkencor. Institucioni ka ngritur struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit. Institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. Zhvillimi i programit të studimit përgjithësisht garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët. Megjithatë, plani mësimor mund të rishihet në mënyrë të tillë që t'i lihet më shumë hapësirë lëndëve që synojnë thellimin e njohurive gjuhësore në anglisht dhe që përforcojnë kompetencat e nevojshme profesionale dhe shkencore. Planin mësimor nuk reflekton lëndë të teknologjisë së informacionit (në përputhje me VKM nr.41, dt. 24.01.2018). Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Paragraf përmbledhës FUSHA 4: Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit

Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit. Institucioni ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente. Institucioni vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit. DEA e shfrytëzon Laboratorin e gjuhëve të huaja pjesërisht për lëndët që rrisin aftësinë e të folurit; rrjedhimisht, njësia duhet të rrisë gamën e përdorimit të Laboratorit të Gjuhëve të huaja në lëndët e kurrikulës dhe të sigurojë përdorimin e programeve kopjuterike të krijuara enkas për mësimin, praktikimin dhe testimin e gjuhëve të huaja. Departamenti duhet gjithashtu të krijojë mundësinë e përdorimit të laboratorit edhe në lëndën e përkthimit, analizës së tekstit, fonetikës dhe letërsisë me software-t/shërbimet përkatëse. Institucioni vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën dhe mjedise të posaçme të mësimnxënies. Duhet të konsiderohet mundësia për pasurimin e bibliotekës fizike në institucion me botime që i shërbejnë dhe janë në funksion të programit të studimit Bachelor në Anglisht, përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse. Institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit. Institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Paragraf përmbledhës FUSHA 5: Studentët dhe mbështetja e tyre

Institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. Institucioni vë në dispozicion

të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm. Institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Paragraf përmbledhës FUSHA 6: Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit bachelor

Kuadri ligjor institucional i sigurimit të brendshëm të cilësisë në këtë program studimi është i përcaktuar dhe mirëpërkufizuar. Ai definon procedurat, mekanizmat dhe aktorët kryesorë që përfshihen në proces. Dokumentacioni i paraqitur në lidhje me reflektimin e sa më sipër në dosjen që shoqëron RVB të këtij programi është dokumentacion standard; me fjalë të tjera shembuj të paplotësuar të formularëve, raporteve dhe pyetësorëve, ose shkresa/vendime të miratimit të krijimit të strukturave të sigurimit të cilësisë, të ekspertëve të jashtëm të matjes së saj dhe të kuadrit ligjor rregullator të këtij procesi. Nuk është paraqitur asnjë raport analitik i tyre dhe aq më pak një plan veprimi që të pasojë gjetjet e kësaj analize. I vetmi dokument që pasqyron një përshkrim të mekanizmave të sipërpërmendur të cilësisë është Raporti i veprimtarisë vjetore [53], edhe në të cilin sa më sipër ka karakter deskriptiv dhe konstatues. Në shembullin e paraqitur gjetjet kanë qenë kryesisht pozitive dhe shumë pranë pritshmërive të njësisë. Kjo lë të kuptohet që njësia nuk ka pasur nevojë të ndërmarrë masa në lidhje me përmirësimin e problemeve të kontatuara. Për më tepër, në intervistat e zhvilluara me grupet e interesit gjatë vizitës në institucion, shembujt e sjellë në lidhje me sigurimin e cilësisë ishin thujasë të njëjtë, gjë që lë të kuptohet se ky proces nuk është një kulturë e vazhdueshme e njësisë që të sigurojë vijimësinë e procesit nga viti në viti dhe gjithpërfshirjen më të vetëdijshme të stafit akademik dhe studentëve.

Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 20.11.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 80/18 Prot, datë 20.11.2020. Universiteti Privat “Albanian University” përcjell në ASCAL më datë 26 nëntor, me anë të shkresës me Nr. 451/1 Prot, datë 25.11.2020, “Kthim përgjigje shkresës suaj Nr.80/18 Prot, datë 20.11.2020”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Paragrafin përmbledhës FUSHA 4;**
“Duhet theksuar se laboratorit që përdoret nga DEA për këtë program nuk ka të instaluar asnjë platformë apo software për mësimin e gjuhës së huaj”.

Argumenti i GVJ: Në vijim të komentit të dërguara nga Departamenti pas shqyrtimit të RVJ dhe evidencave përkatëse, GVJ vendos: Zëvendësimin e fjalisë “Duhet theksuar që laboratorit që përdoret nga DEA për këtë program nuk ka të instaluar asnjë platformë apo software për mësimin e gjuhës së huaj” [Paragraf përmbledhës Fusha 4, faqe 7 RVJ], dhe zëvendësimin e tij me: “DEA e shfrytëzon Laboratorin e gjuhëve të huaja pjesërisht për lëndët që rrisin aftësinë e të folurit; rrjedhimisht njësia duhet të rrisë gamën e përdorimit të Laboratorit të Gjuhëve të huaja në lëndët e kurrikulës dhe të sigurojë përdorimin e programeve kopjuterike të krijuara enkas për mësimin, praktikimin dhe testimin e gjuhëve të huaja. Departamenti duhet gjithashtu të krijojë mundësinë e përdorimit të laboratorit edhe në lëndën e përkthimit, analizës së tekstit, fonetikës dhe letërsisë me software-t/shërbimet përkatëse”.

Zëvendësimin e paragrafit [Standardi III.3, Kriteri 7], “Megjithatë rekomandohet që laboratorit të pajset me programe (software) të specializuara në shërbim të lëndëve të caktuara që zhvillohen në laborator”. me paragrafin: “DEA e shfrytëzon Laboratorin e gjuhëve të huaja pjesërisht për lëndët që rrisin aftësinë e të folurit; rrjedhimisht njësia duhet të rrisë gamën e përdorimit të Laboratorit të Gjuhëve të huaja në lëndët e kurrikulës dhe të sigurojë përdorimin e programeve kopjuterike të krijuara enkas për mësimin, praktikimin dhe testimin e gjuhëve të huaja. Departamenti duhet gjithashtu të krijojë mundësinë e përdorimit të laboratorit edhe në lëndën e përkthimit, analizës së tekstit, fonetikës dhe letërsisë me software-t/shërbimet përkatëse”. **GVJ vendos që Raporti të ndryshojë.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Anglisht”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” ofrohet në përputhje me përcaktimet e Statutit [10, neni 7], dhe të Planit Strategjik të “Albanian University” [7] me synim kualifikimin e specialistëve të aftë të operojnë në tregun aktual të punës. Këtë e parashikon edhe Plani Starategjik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes (DEA) [9] si dhe Rregullorja e kësaj njësie [77, neni 3]. Programi synon pëmbushjen e interesave kombëtare me anë të kualifikimit të specialistëve në mësimdhënie, përkthim dhe interpretim [17, fq.3].
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes synon ruajtjen e vazhdueshme të vlerave akademike dhe kulturore kombëtare, të detajuara këto në kornizën ligjore që rregullon veprimtarinë e kësaj njësie [10/8/9/7]. Njësia synon që, me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor që ofron, të aftësojë studentët të përdorin me efikasitet gjuhën e huaj dhe të përvijojnë studime të thelluara të ciklit të dytë në fushat e mësimdhënies, përkthimit ose interpretimit në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore që mbart një institucion i arsimit të lartë në Shqipëri.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi është hartuar në përputhje me objektivat e DEA-s, si njësi që ofron kualifikim kryesisht në fushën e mësimdhënies, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Vetë programi synon zhvillimin e shprehive gjuhësore në gjuhën angleze, mësimdhënien e saj, formimin kulturor, letrar dhe shoqëror të studentit [16/17]. Ai synon nxitjen e të menduarit kritik të studentët dhe angazhimin e tyre në kërkim shkencor të aplikuar në fushat e mësipërme [20-43].
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Edhe pse RVB sugjeron që programi “Anglisht” “përbëhet kryesisht nga lëndë që adresojnë funksionimin e institucioneve ekonomike, bankare dhe financiare [RVB, fq.5], në fakt orinetimi kryesor i programit duket të jetë aftësimi gjuhësor mësuesve të ardhshëm të gjuhës angleze si gjuhë e huaj dhe kualifikimin e specialistëve të kësaj të fundit në nivelin bazë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> <p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> <p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Misioni i programit është konceptuar në harmoni me atë të njësisë që ofron, në përputhje me formimin shkencor të pedagogëve të kësaj njësie, kryesisht në fushën e mësimdhënies dhe edukimit [89]. Plani strategjik i zhvillimit të kësaj njësie specifikon si drejtime të ardhshme të zhvillimit ofrimin e programeve të studimit që përputhen me aktivitetin e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe të vetë Universitetit [10, neni 2].</p> <p>Duke qenë se Statuti dhe Rregullorja e përgjithshme i përcaktojnë drejtimit e tyre të zhvillimit në përgjithësi, pa specifikuar ato më prioritetet ose drejtimit më konkrete të zhvillimit, është e vështirë të thuhet se programi i studimit përputhet plotësisht me kuadrin e tyre. Gjithësesi, aktiviteti i këtij programi duket të jetë në kuadrin e parashikuar nga zhvillimet e Planit strategjik institucional 2017-2022 [7].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin	Rregullorja e programit Bachelor në “Anglisht” parashtrohet në mënyrë të përgjithshme objektivat e tij. Të vetmet që mund të detajohen janë:

<p>e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>- përgatitja e ekspertëve të aftë për të operuar në profilin e diplomës së ciklit të parë dhe për të dhënë kontributin e tyre si: mësues, interpret, përkthyes;</p> <p>- ofrimi i njohurive bazë që mundëson ndjekjen e studimeve në cikle të mëtejshme studimi, por pa specifikuar profilet më të aftërta të studimit në ciklin e dytë. [17, neni 3/4] Departamenti nuk ka të përcaktuara qartë objektivat përcaktuese dhe specifike të programit të studimit dhe kompetencat që ai i ofron të diplomuarit.</p> <p><i>Në këtë kuadër GVJ rekomandon që, rregullorja e programit të studimit duhet të përcaktojë qartë fushat e formimit akademik që synon të ofrojë me anë të kurrikulës; kompetencat/rezultatet e të nxënit; fushat e kërkimit shkencor aplikativ (për një program të ciklit të parë); kuadrin e studimeve të ciklit të dytë për të cilat ai i kualifikon studentët e diplomuar.</i></p> <p><i>Rregullorja e studimit duhet të përmbledhë gjithashtu njohuritë/rezultatet e të nxënit që ofrojnë kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese, me qëllim specifikimin e objektivave formuese të programit të studimit sipas sugjerimeve në Standardin II.4 të këtij raporti.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Detajimi i objektivave bëhet më i qartë në studimin e tregut të punës të organizuar nga DEA, në të cilin specifikohen institucionet në të cilat mund të punësohen të diplomuarit e këtij programi, të tilla si: institucione publike dhe jopublike ku kërkohen zotërues të gjuhës së huaj, agjensi të ndryshme shërbimesh, institucione mediatike, organizata ndërkombëtare dhe institucione arsimore. Objektivat e tjerë më specifike janë po ashtu parashtruar në këtë material, kryesisht të ndarë në mënyrë të barasvlefshme mes kualifikimit gjuhësor dhe atij mësimdhënës të studentit [11, fq. 2-3]</p> <p>Pavarësisht sa më sipër, studimi i tregut është fokusuar në institucionet që ofrojnë mësimdhënie në arsimin parauniversitar dhe konkludon se DEA disponon burimet njerëzore për të ofruar kualifikim e duhur për kërkesat e tregut në këtë drejtim [11, fq.10]. Në fakt, studimi duket se është më tepër pjesë e nevojës për hapjen e programeve të ciklit të dytë: MP në “Gjuhë angleze” me profil Anglistikë- Amerikanistikë/ Përkthim dhe MSH në “Mësuesi në Gjuhën angleze AML” [9], për të cilat njësia ka aplikuar tashmë [Tak.1]</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e</p>	<p>Struktura e programit është hartuar në mënyrë që të garantojë përfundimin e dijeve bazë në fushën e gjuhësisë angleze, përfundimit të aftësive të përdorimit të saj, studimin e saj gramatikor dhe leksikor, si dhe formimin kulturor të studentit në drejtimin letrar</p>

dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	<p>dhe historik [80]. Gjithësesi, një pjesë e konsiderueshme e rezultateve të të nxënit që synon kurrikula, i përkasin formimit psiko-pedagogjik të studentëve si mësues të ardhshëm të gjuhës angleze, ndërkohë që Ligji 80/2015 (neni 83) ua njeht formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë vetëm programeve të ciklit të dytë.</p> <p><i>Në këtë kuadër GVJ rekomandon që: kurrikula e programit bachelor në “Anglisht” duhet të ristrukturohet me qëllim pakësimin e njohurive në fushën e mësuesisë dhe vënien e 30 ECTS që i përkasin aktualisht kësaj të fundit në dispozicion të formimit më të plotë dhe më të thelluar gjuhësor të studentit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi I.4</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>DEA është pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe bashkëpunon me njësitë e tjera bazë të këtij të fundit. Aktualisht DEA për vitin akademik 2019-2020 ka gjithsej 25 pedagogë nga të cilët 12 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 2 “Profesorë të Asociuar”, 8 “Doktorë shkencash”, 1 “Doktorant dhe 1 “Msc”, dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 “Profesor”, 2 “Profesorë të Asociuar”, 8 “Doktor shkencash”. dhe 6 “Msc”. [3, tab. 1].</p> <p>Për mbarëvajtjen e programeve që ofron, DEA punëson edhe 13 staf akademik me kohë të plotë të FSHSH dhe 14 staf akademik me kohë të pjesshme nga të cilët 1 Akademik të Asociuar, 1 Profesor Doktor, 3 Profesorë te Asociuar, 8 Doktorë shkencash dhe 1 MSc [3, tab.2].</p> <p>Në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Anglisht” për vitin akademik 2019 – 2020 rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 14 pedagogë gjithsej, nga ku 9 pedagogë efektiv (PAE) nga të cilët: 7 Dr., 1 Dr.proc., dhe 1 Msc.), dhe 5 pedagogë me kontratë (PAK) nga të cilët: 1 Prof.Dr.dhe 4 Dr.) [3, tab. 2].</p>

	Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2019-2020 rezulton 65% me 35%.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi ofron kualifikim të nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe ka për qëllim përgatitjen e specialistëve dhe mësuesve të gjuhës angleze. Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e këtij programi përkojnë me fushën akademike dhe kërkimore të FSHSH dhe të DEA-s. Në fakt, programi Bachelor “Anglisht” është i vetmi program studimi që ofrohet për gjuhën e huaj nga kjo njësi [7].			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Njësia Bazë ku bën pjesë programi i studimit Bachelor në Anglisht është Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Ky Departament ofron edhe 2 programe të tjera Bachelor në: “Mësuesi për Arsimin Fillor”, “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, si dhe programin e studimit Master profesional në: Pedagogji me Profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” [77, neni 6]. Nga 14 pedagogë me kohë të plotë dhe të pjesshme që mbulojnë lëndët/modulet e programit 7 kanë kualifikim në gjuhën angleze, 3 në gjuhën shqipe, 1 në gjuhën frënge, 2 në psikologji dhe 1 në filozofi/sociologji [89].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet	DEA ofron këtë program në bashkëpunim me njësitë e tjera bazë të FSHSH dhe me staf të ftuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” [3, tab.6.1]. Për mbarëvajtjen e tij, ai bashkëpunon gjithashtu në mënyrë koherente me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, Zyrën

<p>ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>e Karrierës dhe Alumnit, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën për Koordinimin dhe mbështetjen e studentëve [Tak. 4/5/7/8].</p> <p>Pjesa dërrmuese e dokumentacionit ligjor që rregullon mbarëvajtjen e këtij programi, me përjashtim të rregullores së programit, është hartuar në rang institucional. Ndarja e përgjegjësive dhe analizës së vazhdueshme të punës në nivel njësie bazë, rregullohet nëpërmjet, Rregullores së DAS-s [77] dhe Rregullores së programit të studimit [17].</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p> <p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>DEA bashkëpunon me institucione të tjera arsimore ose jo në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkuara nga “Albanian University” dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore [12/3, tab.5], prej të cilëve DEA bashkëpunon për të gjitha programet e studimit që ofron dhe janë institucione joarsimore [3, tab.5].</p> <p>Në rastin e aktivitetit konkret të njësisë për realizimin e objektivave të këtij programi studimi, DEA ka nënshkruar për herë të parë një marrëveshje ERASMUS + me synim mobilitetet staf dhe studentë me një Universitet në Vjenë [13].</p> <p><i>Në këtë kuadër GVJ rekomandon që departamenti të zgjerojë kuadrin e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me insitucione ndërkombëtare të arsimit të lartë, për të rritur mundësitë e mobilitetit të stafit, përditësimit të infrastukturës dhe rritjes së kapaciteteve në programin në fjalë.</i></p> <p>DEA gjithashtu bashkëpunon kryesisht me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Tiranë [14] në lidhje me kryerjen e praktikave mësimore të studentëve të vitit të tretë. Për mbikëqyrjen e studentëve në zhvillimin e praktikës profesionale, DEA cakton pedagogun përkatës i cili bën të mundur koordinimin e studentit praktikant me institucionin përgjegjës për zhvillimin e praktikës, ndjek të gjithë ecurinë e studentit praktikant gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale, si dhe mbi të gjitha krijon një lidhje bashkëpunimi me mentorin e studentit praktikant [84/Tak.1/Tak.5]. Studentët nuk kryejnë praktika të një lloji tjetër në insitucione apo zyra joarsimore [Tak.5].</p> <p>Mbarëvajtja e marrëveshjeve të bashkëpunimit, diskutohet në Raportin e veprimtarisë vjetore [53] dhe në raportet e vetvlerësimit [Tak.1].</p> <p>Departamenti ka një kuadër minimal/modest marrëveshjesh me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë.</p> <p><i>GVJ rekomandon që, departamenti duhet të përpiqet që marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar fakulteti ose</i></p>

	<i>universiteti me insitucione joarsimore t'i shfrytëzojë në të mirë të praktikës profesionale të studentëve në fushat e përkthim/interpretimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” është i hartuar në përputhje me nenet 70 dhe 73 Ligji 80/2015, si dhe VKM nr.41, dt.24.01.2018. Ai është i organizuar në tre vite akademike me 60 kredite secili, 180 kredite në përfundim të vitit të tretë. Në përfundim të studimeve ofrohet diploma Bachelor në “Anglisht”, e shoqëruar nga suplementi përkatës [56/58/59].</p> <p>Plani mësimor i programit reflekton ndarjen e lëndëve dhe moduleve përkatëse sipas kategorive lëndore dhe pasqyron ngarkesën e tyre në kredite të shprehur në teori/praktikë, në orë të studimit në auditor dhe orë të studimit individual. Ngarkesa e krediteve është llogaritur sipas ndarjes në</p>

<p>gjerë profesionale e specialitetesh.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> <p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>leksione/seminare/ushtrime/laboratore/detyra/projekte dhe praktikë [80].</p> <p>Programi është hartuar në referencë të nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe synon formim në gjuhën angleze, formim në një gjuhë të huaj të dytë, mësimin e gjuhës angleze për qëllime specifike dhe mësimdhënien e kësaj të fundit [80]. Plani mësimor reflekton një ndarje të cinguar të krediteve në disfavor të lëndëve të specialitetit, të cilat për një program të ciklit të parë duhet t'i përkasin formimit të thelluar dhe të gjithanshëm të specialistëve të gjuhës angleze.</p> <p>Për formimin gjuhësor të studentit janë llogaritur 101 ECTS nga të cilat 14 janë për gjuhën frënge; për studimin e thelluar 16 ECTS; për lëndë të karakterit të përgjithshëm kulturor 29 ECTS dhe për lëndët e formimit psiko-pedagogjik 36 ECTS nga të cilat 7 ECTS i kushtohen praktikës profesionale (e cila zhvillohet në shkollë të arsimit parauniversitar).</p> <p><u>Kurrikula:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk reflekton lëndë të teknologjisë së informacionit (në përputhje me VKM nr.41, dt. 24.01.2018); - ka një mbingarkesë në lëndët e profilit mësimdhënës (të cilat në fakt duhet të jenë pjesë e formimit të ciklit të dytë); - ofron njohuri të përgjithshme në formimin e shprehive gjuhësore të aplikuara (lënda e Analizës së tekstit ofrohet në vetëm dy vite akademike); - nuk lejon formim të thelluar në aspektet e morfologjisë dhe sintaksës angleze; - parashikon ngarkesë të tepruar për disa lëndë jodrejtpërdrejt të lidhura me objektivat e programit (Histori e artit/Histori e qytetërimeve 7 ECTS/Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci 8 ECTS); - cungon njohuritë e nevojshme të formimit kulturor dhe letrar të studentit në Histori e kulturës Anglo-Amerikane 7 ECTS/ Letërsi Angleze-amerikane 7 ECTS), kur në fakt këto lëndë mund të jenë të përbëra nga module të qenësishme që ofrojnë formim të plotë rreth qytetërimeve dhe vlerave përkatëse. <p><u>Plani mësimor nuk paraqet mundësi për studime të avancuara, ose krahasuese në këtë fushë akademike.</u></p> <p>Duke qenë se lëndët përbërëse janë të gjitha me ngarkesë 6-8 ECTS, ato nuk lejojnë profilizimin e mëtejshëm të njohurive bazë që ofrojnë. Në kurrikul mungojnë lëndë të studimit diakronik të gjuhës angleze, të studimit të thelluar të gramatikës dhe leksikut</p>
--	---

	<p>të saj, lëndë apo module që fokusohen në stilin e të shkruarit të gjuhës, lëndët që ofrojnë njohuri mbi lidhjen gjuhë-kulturë/sociolinguistikë janë thuajse sfumuar nën profilizime të pastra historike, sociologjike, dhe pedagogjike të lëndëve të sipërpërmendura.</p> <p><u>Nga sa më sipër GVJ rekomandon:</u></p> <p>- <i>Uljen e ngarkesës së krediteve në lëndët aktuale dhe shtimi i profileve të moduleve që ofrojnë formim të specializuar dhe profesional në gjuhën angleze;</i></p> <p><i>Lëndët e profilit psiko-pedagogjik të kalojnë si lëndë me zgjedhje ose të zëvendësohen nga lëndë të karakterit gjuhësor (një gjuhë e dytë e huaj, ose anglishte me qëllime specifike);</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore është njëri prej tre njësive kryesore të Albanian University. Ai ka në përbërje të tij katër Departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative; 2. Departamentin e Shkencave Juridike; 3. Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme; 4. Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes.[10, neni 14]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatorin e programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ofron tre programe të ciklit të parë dhe një program të ciklit të dytë, master profesional.</p> <p>DEA për vitin akademik 2019 -2020 ka në përbërje të tij 12 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 2 “Profesorë të Asociuar, 8 “Doktorë shkencash”, 1 “Doktorant dhe 1 “Msc”, dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 “Profesor”, 2 “Profesorë të Asociuar”, 8 “Doktor shkencash”. dhe 6 “Msc”. [3, tab. 1].</p> <p>Në dy vitet e mëparshme akademike raportet PAE/PAK të departamentit përgjegjës për programin e studimit kanë qënë:</p>

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Për vitin akademik 2017-2018, (12 / 15), nga këta me grada/tituj shkencore 12 / 11;</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (12 / 14), nga këta me grada/tituj shkencore 12 / 11;</p> <p>Në tre vitet e fundit ai reflekton qëndrueshmëri të stafit me kohë të plotë. [3, Tab.1.1/1.2/1.3]</p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit koordinon programin e studimit dhe ecurinë e veprimtarive përkatëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij detajohen në Rregulloren e Departmentit [77, neni 9]. Po ky dokument përcakton edhe detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit [15], të grup-lëndëve/ të programit të studimit [77, neni 12]. Gjithsesi, nga intervista me këtë të fundit u vu re se koordinimi mes të dyve fokusohet kryesisht në mekanizma të sigurimit të brendshëm të cilësisë (si pjesë e NJSBC) sesa në elementët përkatës të kurrikulës, ngarkesës lëndore, përputhjen e kualifikimit të stafit me fushën e mësidhënies, etj [Tak. 1/3]. Mund të thuhet se rolin e koordinatorit e mbulon vetë përgjegjësi i departamentit.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3</p> <p>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>FSHSH dhe DEA disponojnë dokumentacionin e nevojshëm bazë mbi të cilin funksionon dhe menaxhohet programi i studimit Bach. në “Anglisht”. [7/8/9/10/16/7/18/19/77]. Ato përcaktojnë kornizën ligjore të funksionimit të programit, strukturën akademike që e ofron dhe strukturat e tjera mbështetëse, objektivat e programit dhe kompetencat e formimit, kriteret hyrëse, planin mësimor dhe programet lëndore, procedurat e diplomimit dhe formimin profesional të të diplomuarve.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete</p>	<p>Programi Bsc. në “Anglisht” është i organizuar në 180 ECTS në shtrirje tre vjeçare, me gjashtë semestra (15 javë); semestrat e vitit</p>




formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	I dhe III kanë nga 30 ECTS secili; ata të vitit II kanë ndarje 29/31 ECTS [16/17]
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Kjo ngarkesë është e reflektuar në planin mësimor të programit, i cili pasqyron: - Ndarjen e veprimtarive sipas kategorive të përcaktuara në Ligjin 80/2015, nenet 6/25, 70, 73 dhe VKM nr.41, dt. 24.01.2018 [Për referencë gjithashtu Standardi II.1, Kriteri 6] - Ndarjen vjetore dhe semestrare të ngarkesës në leksione/seminare, orë në auditor (1847 orë/përfshi edhe orët e praktikës profesionale) dhe orë jashtë auditorit (2653)
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Ngarkesa mësimore e orëve në auditor për leksione, seminare dhe forma të kontrollit të vazhdueshëm është 25 orë 50-minutëshe në javë. [77, neni 20] Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit dhe programeve lëndore janë të përcaktuara gjithashtu kriteret e frekuentimit dhe instrumentet e vlerësimit. [17].
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	DEA gjithashtu përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, të transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve [17/19/66]. Pranimi i studentëve bëhet në përputhje me udhëzimet në fuqi të MASR. Njësia përcjell për miratim propozimet për kritere dhe kuota pranimi dhe transferimi, bazuar në kapacitetet pritëse [19].
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ ka shqyrtuar edhe programet lëndore përkatëse të programit të studimit të cilat janë pjesë e DVV. Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me praktikat, seminarat apo orët e laboratorit (nëse ka) si edhe orët brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, dt. 24.01.2018. [20-42]. Ato përditësohen në vijimësi sipas parimeve dhe kriterëve të legjislacionit në fuqi. [18]
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi është në përditësim të vazhdueshëm në pëmbushje të detyrimeve që vijnë nga ndryshimet ligjore [18], nevojat e tregut dhe kërkesat e studentëve. Propozimet e departamentit për ndryshime në kurrikul kalojnë në SA dhe i përcillen MASR në rastet kur i kalojnë 20% të masës së ndryshimeve të kurrikulës [83/Tak. 1].




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Në referencë të vlerësimit të Standardit II.3, kriteri 2, mund të thuhet se ngarkesa e programit të studimit Bch. në “Anglisht” është strukturuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Ngarkesa e programit shtrihet në gjashtë semestra 15 javorë. Lëndët dhe modulet përkatëse shpërndahen në mënyrë koherente në semestra, duke ruajtur ngarkesën e përcaktuar në auditor gjatë javës.</p> <p>Plani mësimor paraqet të dhëna të plota në lidhje me lëndën dhe modulet përkatëse, përkatësinë vjetore/semestrare të lëndës, ngarkesën e krediteve në total dhe ndarjet e ECTS brenda lëndës në leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra/projekte dhe praktikë.</p> <p>Në këtë kuadër vihet re se ka lëndë të cilat janë llogaritur me një ngarkesë leksionesh më të madhe se ç’ë kërkon natyra e formimit praktik që ofrojnë. Të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Frëngjisht (14 ECTS/ 6 ECTS leksione-4ECTS seminare-4 ECTS ushtrime) [22/23]; - Anglishte e folur (në syllabus Gjuhë e folur) (8 ECTS- 3 ECTS leksione, 2 ECTS seminare, 1 ECTS ushtrime, 1 ECTS detyrë, 1 ECTS laborator) [6]; - Analizë teksti (viti II) (8 ECTS/ 4.5 ECTS leksione, 2 ECTS seminare, 1 ECTS ushtrime, 0.5 detyrë) – Po e njëjta ngarkesë për lëndën Analizë teksti që zhvillohet vitin III; - Shkrim krijues (8 ECTS/ 4.5 ECTS leksione, 2 ECTS seminare, 1 ECTS ushtrime, 0.5 detyrë); <p>Kurrikula parashikon ngarkesë në laborator për shtatë module, megjithatë, DEA nuk disponon asnjë program të mësimdhënies së</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	

<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>gjuhës së huaj apo software kompjuterik që të mundësojë mbulimin e ngarkesës së parashikuar në laborator për lëndët Frengjisht, Fonetikë, Leksikologji, Anglishte e folur, Linguistikë, didaktikë e gjuhëve të huaja, Teori dhe praktikë përkthimi, Shprehi komunikimi. Lënda “Teori dhe praktikë përkthimi” duhet të parashikojë më tepër orë pune në laborator (me sigurimin e një software-i të përshtatshëm) duke qenë se programi ka si objektiv të vetin formimin e përkthyesve/interpretëve.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p><i>GVJ rekomandon rishikimin në kurrikul të gjithë sa më sipër.</i></p> <p>Lënda “Analizë teksti” duhet të zhvillohet që në vitin e parë dhe të ketë shtrirje tre-vjeçare, falë rëndësisë që ka në formimin e katër aftësive gjuhësore praktike.</p> <p>Lëndët “Gramatikë: Morfologji-Sintaksë” dhe “Gjuhë shqipe” duhen zhvilluar në dy semestra sipas moduleve përkatëse (Morfologji shqipe/Morfologji angleze dhe Sintaksë shqipe/Sintaksë angleze). Madje do të ishte mirë që formimi morfo-sintaksor në gjuhën shqipe të plotësohej para atij në gjuhën angleze, në mënyrë që studenti të ketë njohuri të plotë të koncepteve bazë të gjuhës shqipe, para se të përballet me ato të gjuhës angleze.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet lëndore përditësohen sipas nevojës, në çdo fillim viti akademik. Pedagogët bëjnë përditësimin e tematikës (kur e gjykojnë të rëndësishme) dhe të literaturës (në varësi të botimeve të publikuara rishtasi) [Tak.1/ Tak.3]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi prashikon kryesisht kualifikim në gjuhën angleze të mësuesve të ardhshëm dhe përkthyesve/interpretëve. Në fakt, objektivi kryesor i programit, si program i ciklit të parë që është, duhet të jetë formimi i specialistëve të gjuhës angleze, të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> -kanë njohuri të thelluara në strukturat gjuhësore të saj;
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -njohin cilësitë e saj fonetike, strukturat morfo-sintaksore dhe tiparet e saj leksikore; -janë të aftë t’i përdorin ato rrjedhshëm në situata dhe stile të ndryshme të ligjëritimit të folur dhe të shkruar; -njohin zhvillimin diakronik të këtyre proceseve dhe shpjegojnë transformimet gjuhësore nga periudha në periudhë;

<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me</p>	<p>- njohin historinë dhe qytetërimin e vendeve anglishtfolëse dhe shpjegojnë mënyrat e ndërsjellta të ndikimit të tyre në proceset gjuhësore;</p>			
<p>kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>- njohin zhvillimet letrare të vendeve anglishtfolëse dhe mundën të analizojnë vepra të këtyre të fundit me qëllim formimin e tyre kulturor;</p> <p>- kanë aftësi të komunikojnë dhe zotërojnë fjalor të gjuhës angleze në drejtimit kryesor të përdorimit të saj si gjuhë e huaj (kryesisht shkencat shoqërore- falë profilit të njësisë që e ofron këtë program); dhe</p> <p>- zotërojnë konceptet bazë të përkthimit dhe komunikimit ndërgjuhësor.</p> <p>Këto njohuri, të formësuara në module/lëndë konkrete, do ta aftësonin studentin të ndiqte programe të profilizuara të cilkit të dytë në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze, përkthim/interpretimit, studime të thelluara gjuhësore, komunikim dhe media, turizëm, etj. pa kaluar në përsëritje njohurish tashmë të marra në ciklin e parë (ashtu si me gjasë ndodh tashmë me studentët aktualisht të diplomuar në këtë program, që zgjedhin të ndjekin një program mësuesie në ciklin e dytë.</p> <p>Në këtë kuadër, edhe studimi i tregut të punës dhe analiza e tij e kryer nga DEA [11], duhet të dalë nga kuadri i insitucioneve arsimore, dhe të përfshijë edhe insitucione që ofrojnë punësim në fushat e sipërpërmendura. Kjo ndoshta do të ofrojë një njohje më gjithpërfshirëse të specializimeve që kërkon tregu për formimin në gjuhë angleze dhe si rrjedhojë do ta ndihmojë njësinë të bëjë ristrukturimet e duhura në kurrikulën e ciklit të parë “Anglisht”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit,</p>	<p>Programi mbulohet nga personel me kohë të plotë i kategorisë “profesor”, “lektor” dhe “asistent –lektor” [Standardi II.2, kriteri 1]. GVJ nga shqyrtimi i [3, tab.6.1, 6.2 dhe 6.3] konstaton se</p>




<p>përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>personeli akademik i angazhuar në këtë program ka së paku kualifikimin e ciklit pasardhës në fushën e programit.</p>																		
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në program mbulon ngarkesë mësimore sipas profilit në këtë program, por edhe në programe të tjera.</p> <p>Personeli me kohë të plotë pranë njësisë mbulon 1515 orë në auditor të kurrikulës, ose 82,1% të ngarkesës së saj [3, tab. 4], në përputhje me kërkesat e VKM 418, 2017.</p> <p>Ka pedagogë me kohë të plotë që kanë një total prej 447/597/656 orësh, që reflekton mbingarkesë në mësimdhënie. [3, tab.4]</p> <p>Stafi kualifikohet më tej në disiplinat përkatëse dhe promovon kërkimin e vet shkencor ç</p>																		
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Në mënyrë më të detajuar dhe referuar të dhënave (3, tab 6.1, 6.2 dhe 6.3), po paraqesim si më poshtë përbërjen e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për të tre vitet akademike:</p> <p>GJITHSEJ per vitin akademik 2019 – 2020 kanë dhënë mësim 14 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 5 PAK (në raportet 65%/35%)</p> <table data-bbox="778 1003 1157 1160"> <tr> <td><u>PAE:</u></td> <td><u>PAK:</u></td> </tr> <tr> <td>7 Dr</td> <td>1 Prof.Dr</td> </tr> <tr> <td>2 Msc</td> <td>4 Dr</td> </tr> </table> <p>GJITHSEJ per vitin akademik 2018 – 2019 kanë dhënë mësim 11 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 4 PAK (64%/36%)</p> <table data-bbox="778 1279 1157 1435"> <tr> <td><u>PAE:</u></td> <td><u>PAK:</u></td> </tr> <tr> <td>6 Dr</td> <td>1 Prof.Dr</td> </tr> <tr> <td>1 Msc</td> <td>3 Dr</td> </tr> </table> <p>GJITHSEJ per vitin akademik 2017 – 2018 kanë dhënë mësim 11 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 4 PAK (64%/36%)</p> <table data-bbox="778 1554 1157 1711"> <tr> <td><u>PAE:</u></td> <td><u>PAK:</u></td> </tr> <tr> <td>7 Dr</td> <td>1 Prof.Dr</td> </tr> <tr> <td></td> <td>3 Dr</td> </tr> </table>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	7 Dr	1 Prof.Dr	2 Msc	4 Dr	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	6 Dr	1 Prof.Dr	1 Msc	3 Dr	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	7 Dr	1 Prof.Dr		3 Dr
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																		
7 Dr	1 Prof.Dr																		
2 Msc	4 Dr																		
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																		
6 Dr	1 Prof.Dr																		
1 Msc	3 Dr																		
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																		
7 Dr	1 Prof.Dr																		
	3 Dr																		
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të</p>	<p>Programi i studimit e ofron Praktikën si modul në kurrikulën e vitit të tretë, semestri i dytë, me 7 ECTS.</p> <p>Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe nëpërmjet pedagogut udhëheqës të praktikave profesionale, Departamenti bën të mundur mbikëqyrjen e studentëve në institucionet ku ata zhvillojnë praktikat profesionale. Udhëheqësi i praktikave</p>																		




<p>duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>profesionale krijon një lidhje bashkëpunimi midis studentit praktikant dhe mentorit në institucionin pritës [84]. Moduli i praktikës në këtë kurrikul duhet rikonceptuar në ngarkesë, përmbajtje dhe zbatim [41].</p> <p>Rregullorja e programit specifikon se studentët mund të zgjedhin të zhvillojnë provimin e diplomës në provim formimi ose punim diplome mbi pragmesataren e dy viteve të para 8.7. Kjo rregullore përcakton gjithashtu edhe modalitetet dhe procedurat e tutoratit dhe mbrojtjes së punimit. [17, neni.23/ 54/55]. DEA vë në dispozicion të studentëve diplomantë Manualin e punimit të diplomës [43].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në realizimin e ngarkesës së këtij programi, DEA angazhon 9 staf akademik me kohë të plotë, 5 staf me kohë të pjesshme [3, tab.2] Në mbështetje të programit janë edhe 6 personel ndihmës-akademik të institucionit (1 kryesekretare, 1 sekretare, 3 IT dhe 1 punonjës biblioteke).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve bazohet kryesisht te pedagogu i lëndës përkatëse dhe kontributi i tij në rishikimin e programeve lëndore në mënyrë të rregullt.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Lidhur me monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, në fund të çdo semestri, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon një pyetësor me studentët e programit të studimit, i cili bën të mundur vlerësimin dhe matjen e performancës së stafit akademik dhe atij administrativ. Duhet theksuar gjithashtu se në Departamentin ku ofrohet programi i studimit në fjalë funksionon edhe Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti [70], i cili bashkëpunon me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë për çështje të cilësisë në nivel departamenti. Gjithashtu, nga drejtuesi i Departamenti të Edukimit dhe Anglishtes, në fund të çdo semestri, plotësohet formulari për personelin akademik, i cili pasqyron ecurinë e anëtarëve të personelit akademik gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Siç u theksua edhe më sipër, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizon një pyetësor me studentët e programit të studimit [44], i cili mundëson vlerësimin dhe matjen e performancës së stafit akademik dhe atij administrativ. Duhet vënë gjithashtu në dukje realizimi i fokus grupeve nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ku pas një përzgjedhjeje të një numri të caktuar studentësh, u drejtohen pyetje lidhur me procesin mësimor, metodat e mësimdhënies të përdorura nga pedagogët, komunikimin me pedagogët dhe stafin administrativ. Për shembull, studentët e programit të studimit Bachelor në Anglisht kanë kërkuar rishikim të programit të lëndës së frëngjishtes. [45]




<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Pas realizimit të pyetësorëve të studentëve apo fokus grupeve (të shpjeguara më lart), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, pas përpunimit të të dhënave, i përcjell rezultatet e tyre në njësisë bazë. Më pas, njësia bazë realizon diskutimin e rezultateve të vlerësimit dhe ja komunikon ato në mënyrë individuale secilit anëtar të personelit akademik. Gjithashtu, rezultatet përfshihen edhe në raportin semestral apo vjetor të departamentit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti zhvillon herë pas here trajnime të stafit akademik në lidhje me elementet e ndryshme të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të saj. Gjithashtu, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon trajnime duke ftuar lektorë të jashtëm vendas apo të huaj për tematika të ndryshme. Për shembull, sipas evidencave të siguruarra [48 dhe 49], gjatë vitit akademik 2018-2019 dhe 2019-2020, janë realizuar trajnime që lidhen me teknologjinë në mësimdhënie, motivimin e studentëve, etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i tërësisë së dokumentacionit të dorëzuar nga ana e institucionit GVJ konstatoi se si rregull i përgjithshëm Institucioni aplikon si forma kryesore të mësimdhënies dhe të transmetimit të njohurive leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit dhe praktika profesionale, e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë.</p> <p>Programet e lëndëve, me të cilat studentët njihen që në fillim të semestrit apo vitit akademik pasqyrojnë elementet thelbësore të lëndës, përfshirë format e mësimdhënies dhe mësimnxënies, mënyra e vlerësimit, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Anglisht siguron një ndërthurje metodash të mësimdhënies, në varësi të natyrës së lëndës dhe objektivave për t'u arritur. Megjithatë, duhet vënë në dukje fakti se orët laboratorike për disa lëndë, si për shembull fonetika, etj, duhet t'i nënshtroheshin orëve laboratorike</p>




<p>mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>më të specializuara, me programe të posaçme në shërbim të realizimit të sukseshëm të objektivave të lëndës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Gjatë diskutimeve me pedagogët e Institucionit, GVJ konstatoi se Institucioni i ofron personelit akademik mundësinë e botimit në revistën e institucionit “Optime”, kundrejt asnjë detyrimi financiar.</p> <p>Gjithashtu, personelit akademik i ofrohet mundësia e trajnimit lidhur me metodat dhe risitë në mësimdhënie. Institucioni siguron gjithashtu mundësinë e financimit të zhvillimit të një konferencë ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Aktualisht Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka në përbërje të vet 12 pedagogë me kohë të plotë nga të cilët 2 Profesorë të asociuar, 8 Doktorë shkencash, 1 Doktorant dhe 1 Master i shkencave [3, tab. 1].</p> <p>Për mbarëvajtjen e programeve që ofron, DEA punëson edhe 13 staf akademik me kohë të plotë të FSHSH dhe 14 staf akademik me kohë të pjesshme nga të cilët 1 Akademik të asociuar, 1 Profesor doktor, 3 profesorë të asociuar, 8 doktorë shkencash dhe 1 MSc [3, tab.2].</p> <p>Në realizimin e programit Bachelor “Anglisht”, DEA angazhon 9 staf akademik me kohë të plotë (7 Dr., 1 Dr.proc. 1 Msc.) dhe 5 staf akademik me kohë të pjesshme (1 Akademik i Asociuar, 4 Doktorë shkencash) [3, tab. 2].</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie, në programet lëndore të hartuara prej tij, parashikon metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Referuar RVB për vlerësimin dhe përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, në fund të çdo moduli apo lënde, pedagogu plotëson formularin e vetëvlerësimit, të cilin ja përcjell departamentit në momentin e përfundimit të lëndës apo modulit.</p> <p>Në fund të formularit, lektori ka një hapësirë ku mund të japë sugjerimet apo reflektimet e tij për vitin që vjen. [50] Ndërkohë, pyetësi i studentëve ndihmon për t’i përfshirë ata në këtë proces të vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies.</p>




Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Metodat e mësimdhënies dhe përbërësit e tjerë të procesit mësimor përcaktohen në programet e lëndëve të hartuara nga pedagogët përkatës. Ndërkohë, elemente të tjera përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Anglisht. [17]			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Metodat e mësimdhënies dhe përbërësit e tjerë të procesit mësimor përcaktohen në programet e lëndëve të hartuara nga pedagogët përkatës. Ndërkohë, elemente të tjera përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Anglisht. Nga takimi me studentët u informuam se ekzistonte prirja për të nxitur autonominë e të nxëniet, e ndërthurur me rolin mbështetës dhe udhëzues të pedagogut [Tak. 6]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Pas verifikimit të dokumentacionit dhe vizitës në Institucion GVJ konstaton se infrastruktura e AU përfshin klasa me hapësira të mëdha dhe laborator në shërbim të departamentit nga i cili ofrohet programi i studimit Bachelor në Anglisht. Auditorët janë të pajisur me video projektor dhe përmbushin kushtet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Gjatë vizitës, GVJ konstaton se në Albanian University klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për të bërë funksional procesin mësimor, si kompjuterat, projektorë, tabela shënimesh Smart, etj. Të gjitha sallat kanë të instaluar sistem kondicionimi ngohje-ftohje.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të	GVJ konfirmoi në ambientet e Institucionit se në shërbim të programit të studimit gjendet laborator i anglishtes. Ky laborator ndihmon studentët në lëndë të caktuara. Ky laborator përbëhet nga njëzet e pesë

<p>konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>kompjutera me kufje, ku studentët realizojnë si punë individuale ashtu edhe të përbashkëta të drejtuara nga kompjuteri qëndror.</p> <p>Laboratori shfrytëzohet për një pjesë të mirë të zhvillimit të lëndëve të këtij programi studimi si Fonetikë, Anglishte e folur, Leksikologji, Didaktikë e Gjuhëve të Huaja.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Anglisht” janë bibliotekat online Questia, Esevier, etj. Megjithatë, duhet të konsiderohet mundësia për pasurimin e bibliotekës fizike në institucion me botime që i shërbejnë dhe janë në funksion të programit të studimit Bachelor në Anglisht, përfshirë literaturën bazë, atë ndihmëse dhe literaturën e parashikuar në programet lëndore. .</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, na u konfirmua se ajo është në dispozicion të studentëve nga ora 08.00 deri në orën 16:00.</p> <p><i>GVJ sugjeron pasurimin e bibliotekës fizike në institucion me botime që i shërbejnë dhe janë në funksion të programit të studimit Bachelor në Anglisht, përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e Universitetit konstatuam se studentët e programit të studimit Bachelor në “Anglisht” kanë akses në bibliotekën online “Questia”, të cilën mund ta shfrytëzojnë për materiale mësimore që lidhen me fushat e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në shërbim të programit të studimit gjendet Laboratori i Anglishtes, i cili shfrytëzohet për një sërë lëndësh të planit mësimor, si Fonetikë, Leksikologji, Anglishte e folur, etj. Orët në laborator për lëndë të caktuara reflektohen në planin mësimor të programit të studimit. [evidenca 15].</p> <p><i>“DEA e shfrytëzon Laboratorin e gjuhëve të huaja pjesërisht për lëndët që rrisin aftësinë e të folurit; rrjedhimisht njësia duhet të rrisë gamën e përdorimit të Laboratorit të Gjuhëve të huaja në lëndët e kurrikulës dhe të sigurojë përdorimin e programeve kompjuterike të krijuara enkas për mësimin, praktikimin dhe testimin e gjuhëve të huaja. Departamenti duhet gjithashtu të krijojë mundësinë e</i></p>

	<i>përdorimit të laboratorit edhe në lëndën e përkthimit, analizës së tekstit, fonetikës dhe letërsisë me software-t/shërbimet përkatëse”.</i>			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 mësimi u zhvillua online për të gjithë studentët e “Albanian University” në platformën Microsoft teams. Ndërkohë, janë zhvilluar trajnime lidhur me rëndësinë e teknologjisë në mësimdhënie. [48]			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët përdorin adresat zyrtare të email-it të ofruara nga institucioni. Ekziston gjithashtu mundësia e shfrytëzimit të sekretarisë online, në të cilën studentët kanë akses dhe mund të sigurojnë një sërë informacionesh.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studenteve me mesatare mbi 8.7 u jepet e drejta të zgjedhin nëse dëshirojnë të diplomohen me provim formimi apo temë diplome. Në rastin e diplomimit me temë diplome, departamenti i përcakton një pedagog udhëheqës i cili duhet të ketë të paktën gradën shkencore Doktor. Pedagogu udhëheqës orienton dhe mbështet studentin gjatë gjithë procedurës së mbrojtjes së temave të diplomave që nga moment i përzgjedhjes së temës deri në realizimin me sukses të saj. Duhet theksuar se pedagogu udhëheqës, përëpara mbrojtjes së temës së diplomës, plotëson formularin e pedagogut udhëheqës [evidenca 55], në të cilin ai jep vlerësimin e tij lidhur me elementet e ndryshme të punimit të temës së diplomës. .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e	Në shërbim të cilësisë në mësimdhënie dhe përmirësimin të funksionimit të aspekteve të ndryshme të programit të studimit, funksionojnë disa njësi apo persona përgjegjës. Kështu, është caktuar koordinatori i programit të studimit [evidenca 15], si dhe

<p>vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>është ngritur Grupi i Cilësisë në nivel Departamenti [evidenca 46] dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [evidenca 68].</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Siç u theksua më sipër, Departamenti, çdo vit, shqyrton performancën e programeve të studimit bazuar në bazën e të dhënave të vetëvlerësimit që u bëhet programeve të studimit që përfshijnë tregues të performancës në mësimdhënie, hulumtim dhe përgjigje ndaj shoqërisë, bazuar në raportin vjetor të departamentit dhe çdo masë strategjike të tij.</p> <p>Gjithashtu, në kudër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe në të gjitha drejtimet që përfshijnë programin e studimit, merren në konsideratë pyetëtori drejtuar studentëve, raporti i vetëvlerësimit të stafit akademik, raporti i vetëvlerësimit mbi programin e studimit si dhe informacioni i marrë nga fokus grupet.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja inovative të mësimdhënies bazohet në kontributin e pedagogëve të lëndëve perkatëse dhe trajnimet e ofruara në shërbim të përmirësimit të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në shërbim të kualifikimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, ekziston një vendim për sigurimin e cilësisë në nivel departamenti [evidenca 70].</p> <p>Ndërkohë, ofrohen edhe trajnime nga Njësia e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes. Aktivitetet trajnuese konstatohen edhe në evidencat 48 dhe 49. [52]</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Siç u theksua më lart, rritja e cilësisë së mësimdhënies synohet të realizohet edhe nëpërmjet kryerjes së trajnimeve të stafit (evidencat janë cituar më lart) dhe aktiviteteve të organizuara nga Njësia e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. [52]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve</p>	<p>Në bazë të rregullores së programit të studimit, personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Pedagogu i lëndës harton programin lëndor dhe çdo vit mund të përmirësojë atë</p>

dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	në një masë të caktuar, me synimin e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe përditësimin me metodat dhe studimet më të fundit.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe aplikimin e metodave të reja. Kjo reflektohet në përditësimin e programeve të lëndës dhe diskutimin e tyre në takimet në department.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se rregullorja e programit të studimit përcakton çështje që lidhen me vlerësimin dhe kontrollin e njohurive të studentëve. Gjithashtu, pedagogët e lëndëve përkatëse përcaktojnë në programet e tyre lëndore mënyrën e vlerësimit dhe testimit të njohurive. Studentët njihen me to në fillim të zhvillimit të lëndës.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion dhe kryesisht nga diskutimet me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lëndë/moduli me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga pedagogu i lëndës/modulit.

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Për vlerësimin e njohurive dhe kompetencave të fituara, studentët i nënshtrohen provimeve në mes të semestrit, provimeve përfundimtare, apo temës së diplomës. .</p> <p>Duhet theksuar se mënyrat e kontrollit të njohurive përcaktohen edhe në Rregulloren e Programit të Studimit..</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar kryhet pas përfundimit të korigjimit të provimit përfundimtar, si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti gjatë semestrit (seminare, testim në mes të semestrit, ese, detyra kursi etj.).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni nuk vë në zbatim ndonjë sistem të caktuar elektronik të testimit dhe vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Komisioni i provimeve përbëhet nga titullari i lëndës dhe nga një pedagog i një fushe të afërt studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar kryhet pas përfundimit të korigjimit të provimit përfundimtar, si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti gjatë semestrit, përfshirë këtu seminare, testim në mes të semestrit, ese, detyra kursi, etj. Testimi i vlerësimit i njohurive me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime me kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me</p>




personel dhe mjete survejimi.	personel. Informacion më i detajuar jepet në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Anglisht, më konkretisht nenet 18 deri 22.			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pas zhvillimit të provimit, në përgjithësi pedagogët diskutojnë me studentët në auditor mbi zgjidhjen e tij. Kjo vlen si për provimin në mes të semestrit, ashtu edhe për provimin përfundimtar.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik i programit të studimit synojnë shmangien e plagjiaturës, kopjimin në provime dhe detyra. Kjo parashikohet edhe në nenin 22 të Rregullores së Programit të Studimit.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas pikës 15 të nenit 18 të Rregullores së Programit të Studimit, stafi akademik ka një afat 7 ditor për vlerësimin dhe paraqitjen e rezultateve pranë sekretarisë mësimore. Më pas, sekretaria mësimore njuh studentët me rezultatet përkatëse ose studentët mund të njihen me rezultatet nëpërmjet sekretarisë online.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Neni 23 i Rregullores së Programit të Studimit përcakton të drejtën e studentëve për njohjen me rezultatin në provim apo edhe mundësinë e rishikimit të vlerësimit.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në rastet kur një student nuk është i qartë nga sqarimi me pedagogun e lëndës, atëherë ngrihet komisioni për rivlerësimin e tezës. E gjithë procedura mbi ankimimin e provimit dokumentohet dhe ruhet në arkivat e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. Megjithatë, nga takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët, rezultoi se nuk kishte pasur asnjë ankesë lidhur me vlerësimin e pedagogëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit synon të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. <i>Megjithatë, GVJ mendon se plani mësimor mund të rishihet në mënyrë të tillë që t'i lihet më shumë hapësirë lëndëve që synojnë thellimin e njohurive gjuhësore në anglisht dhe që përforcojnë kompetencat e nevojshme profesionale dhe shkencore.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Plani mësimor nuk reflekton lëndë të teknologjisë së informacionit (në përputhje me VKM nr.41, dt. 24.01.2018).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në formularin e pedagogut, i cili dorëzohet në fund të çdo semestri, realizohet vetëvlerësimi për lëndën. [50] Aty realizohet matja e treguesve për realizimin me sukses të lëndës apo modulit përkatës si: mësimdhënia, literatura e përdorur, etj. dhe në fund paraqet edhe ndryshimet që duhet të realizohen në vitin pasardhës.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në takimin e zhvilluar në institucion me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, na u komunikua se në fund të lëndës apo modulit, pedagogu trajton çështjet dhe konceptet më të rëndësishme të diskutuara dhe ato shqyrtohen apo përmbledhen përsëri.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik ka realizuar orë mësimore të hapura si dhe seminare me tematika Kjo evidentohet në aktivitetet e pasqyruara në evidencën 48 dhe 52 të ndryshme. [52]
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në	Në programet e lëndëve, përveç elementeve të tilla si numri i krediteve, semestri kur zhvillohet, literatura, etj. përcaktohen edhe kompetencat që duhen arritur apo përforuar. Një pjesë e tyre zhvillohen në orët laboratorike, ndërsa një pjesë e lëndëve,

laboratorë dhe praktikat profesionale.	kryesisht ato me natyrë pedagogjike, ndihmojnë edhe në realizimin e praktikës profesionale.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga takimi në institucion me pedagogët e angazhur në programin e studimit u konstata se ata përfshihen në diskutime, kryesisht gjatë takimeve në department, lidhur me problematika që mund të lindin gjatë zhvillimit të procesit të realizimit të procesit mësimor.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Studentët nxiten të marrin pjesë në aktivitete shkencore të organizuara në institucion, si për shembull konferenca shkencore, trajnime, etj. si dhe të botojnë punimet e tyre në revistën e institucionit.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga takimi me studentët në institucion, u konstatua se Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme organizon çdo vit akademik “Konferencën studentore”. Ndonëse u theksua se ekziston mbështetja financiare për studentët, duhet të ketë një angazhim më konkret në këtë drejtim.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Ekzistojnë një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të tjera arsimore [evidenca 12] por duhet të ketë angazhim më të madh për të rritur mobilitetin e studentëve pasi nga takimi me ta në institucion rezultoi se nuk kishte pasur një nivel të lartë mobiliteti. <i><u>GVJ rekomandon</u></i> rritjen e nivelit të bashkëpunimit real me institucione arsimore jashtë vendit dhe shkëmbimeve studentore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit	Procedura për përmbylljen e programit të studimit me provim formimi ose temë diplome përcaktohet në rregulloren e programit të studimit. Kështu, studentët me mesatare mbi 8.7 kanë të drejtë të zgjedhin nëse dëshirojnë të diplomohen me provim formimi ose

<p>të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>temë diplome. Në rastin e provimit të diplomimit përzgjidhen lëndë nga të tre vitet e studimit dhe u vihen në dijeni paraprakisht studentëve. Një muaj përpara datës së provimit të diplomimit njësia bazë organizon orë konsultimi me studentët dhe stafin akademik lidhur me mënyrën e zhvillimit të provimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p>Studentëve të cilët diplomohen me temë u vihet në dispozicion manuali i punimit të temës së diplomës [evidenca 43], i cili përmban udhëzime për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët u informuam se stafi akademik organizon në fund të semestrit të dytë të vitit të tretë konsultimet e nevojshme për lëndët që përfshihen në provimin e e formimit. Ndërkohë, pedagogët udhëheqës orientojnë dhe udhëzojnë studentët në realizimin dhe mbrojtjen e temës së diplomës.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, provimi final organizohet nga një komision i ngritur nga departamenti dhe i miratuar nga dekani i njësisë kryesore për realizimin e provimit final. Komisioni është i përbërë nga tre ose pesë anëtarë të stafit akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi.</p> <p>Sipas rregullores së programit të studimit, por edhe pas takimit me studentët dhe stafin akademik, rezulton se në testimin final përfshihen lëndë të një rëndësie të veçantë të zhvilluara gjatë programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orientojnë dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Nga takimet e realizuar me personelin akademik dhe studentët rezulton se pedagogët orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni, në varësi të temave, jep asistencën e mundshme në shërbim të realizimit me sukses të temave të diplomës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës</p>	<p>Përveç sigurimit të manualit të punimit të temës së diplomës, të përmendur edhe më sipër, në fund të punimit të temës, përpara se studentin të dorëzojë punimin në departament, udhëheqësi dorëzon “Formualin e Pedagogut Udhëheqës” [55], në të cilin ai jep vlerësimin e tij mbi punimin e zhvilluar nga studentin.</p>

sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.									
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në bazë të udhëzimit për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës në programin e studimit Bachelor në Anglisht, në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Vlerësimi me notë bëhet edhe në rastin e përfundimit të provimit.								
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në bazë të kontratës së studentit [evidenca 57], në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë. Gjithashtu, ai pajiset edhe me suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. [evidenca 59].								
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti gëzon të drejtën të pajiset me programin e plotë të studimeve të zhvilluara përgjatë tri viteve akademike të ndjekjes së programit të studimit. .								
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Gjatë vizitës në institucion, më konkretisht gjatë takimit me punonjëset e sekretarisë mësimore, konstatoam se informacioni për studentët e diplomuar ruhet në arkivat e sekretarisë mësimore								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, zyra e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes disponon dhe përditëson të dhënat që kanë të bëjnë me personelin akademik dhe atë administrativ. Për çdo pedagog të angazhuar në programin e studimit mbahet një dosje ku përfshihen dokumente të tilla si CV-ja, kualifikimet, etj. U njohëm me këto dosje gjatë takimit me stafin e zyrës së burimeve njerëzore gjatë vizitës në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë takimeve me zyrën e burimeve njerëzore dhe përgjegjësen e departamentit, u informuam se nevoja për rekrutim të personelit akademik lind nga departamenti dhe përcillet më pas në dekanat dhe rektorat. (Evidenca 6) (Komisioni për rekrutimin e stafit për vitin akademik 2019-2020) shpjegon procedurën dhe kriteret e caktuara.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në fund të çdo vit akademik paraqet pranë Dekanit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore kërkesat për staf akademik. Në bazë të nenit 30 të rregullores së përgjithshme të universitetit, kandidatët duhet të përmbushin një sërë kriteresh, të cilat më pas trajtohen nga komisioni i ngritur për rekrutim stafi. Sic u shpreh edhe me lart, evidenca 6 (Komisioni për rekrutimin e stafit për vitin akademik 2019-2020) shpjegon procedurën dhe kriteret e caktuara. Ndërkohë, marrëdhënia e punës mes të punësuarit dhe universitetit rregullohet nga kontrata e punës, me kohë të plotë ose të pjesshme, mbështetur ne Kodin e Punës, dhe në respektim të Legjislacionit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë [Tak. 7].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur</p>	<p>Siç u theksua edhe më sipër, në bazë të nenit 30 të rregullores së përgjithshme të universitetit, kandidatët duhet të përmbushin një sërë kriteresh, të cilat më pas trajtohen nga komisioni i ngritur për rekrutim stafi. Komisioni më pas vlerëson nivelin e kualifikimit dhe përputhjen e tij me kërkesat e programit të studimit.</p>




të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ gjatë vizitës në IAL evidentoi se, institucioni ka krijuar mjedise dhe mundësi shumë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit të akademik. Klasat ishin të pajisura me mjete dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e orëve mësimore. Në mjediset e IAL-së nuk mungonte sistemi wireless i aksesueshëm për studentët për tu përdorur prej tyre në webs të nevojshëm për kërkim në funksion të procesit mësimor.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjatë takimit në institucion me anëtarët e personelit akademik dhe autoriteteve drejtuese, u konstatua se stafi akademik angazhohet në konferenca shkencore të organizuara nga institucioni si dhe i jepet mundësia të botojë në revistën shkencore të “Albanian University”. Gjithashtu, strategjia për sigurimin e cilësisë në “Albanian University” [evidenca 71] parashikon ‘trajnimin e stafit akademik çdo fillim viti akademik me profesorë nga universitete të huaja me qëllim ofrimin e një mësimdhënie të standardeve bashkëkohore ku në qendër është gjithmonë studenti dhe nxitja e mendimit të tij kritik’.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Siç evidentohet edhe nga evidencat 48 dhe 49, organizohen trajnime të ndryshme në funksion të përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies dhe kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik. [48, 49]

Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Objektivat e programit të studimit Bachelor në Anglisht synohet të përmbushen duke angazhuar burimet njerëzore në dispozicion të programit të studimit. Në realizimin e programit Bachelor “Anglisht”, DEA angazhon 9 staf akademik me kohë të plotë (6 Dr., 1 Dr.proc., 2 Msc.) dhe 5 staf akademik me kohë të pjesshme (1 Akademik i Asociuar, 4 Doktorë shkencash) [3, tab. 2].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Siç u vërtetua gjatë vizitës së GVJ në institucion, AU zotëron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse në kuadër të programit të studimit, duke marrë parasysh numrin e studentëve, i cili në rastin konkret nuk është shumë i lartë.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Vizita në institucion, dhe konkretisht në klasat e leksioneve dhe seminareve, si dhe në laboratorin në funksion të programit të studimit, u konstatua se ato janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Të gjitha klasat mësimore janë të pajisura me mjetet audio vizive të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor efektiv, ku përfshihen kompjuter personal, video projektor, sistem fonie, sistem kondicionimi dhe internet.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme	Në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Anglisht” është laborator i anglishtes. Megjithatë, duhet theksuar se laborator që përdoret nga DEA për këtë program nuk ka të instaluar asnjë platformë apo software për mësimin e gjuhës së huaj.

për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.				
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Gjatë vizitës në laboratorin në shërbim të programit të studimit, u konstatua se ai ishte i pajisur me një numër të mjaftueshëm kompjuterash Megjithatë, duhet theksuar se laboratori që përdoret nga DEA për këtë program nuk ka të instaluar asnjë platformë apo software për mësimin e gjuhës së huaj.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Sic vërtetohet nga evidenca 12 (Marrëveshjet e bashkëpunimit), praktika profesionale në programin e studimit Bachelor në anglisht zhvillohet në institucione të ndryshme të arsimit parauniversitar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë e cila është lehtësisht e aksesueshme nga studentët. <i>Pavarësisht ekzistencës së saj, duhet të konsiderohet mundësia për pasurimin e bibliotekës fizike në institucion me botime që i shërbejnë dhe janë në funksion të programit të studimit Bachelor në Anglisht, përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e	Biblioteka në shërbim të programit të studimit siguron literaturë të pjesshme fizike, por nuk mbulon literaturën e nevojshme të

<p>mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>parashikuar në programet e lëndëve të ndryshme të cilat janë pjesë e planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Anglisht.</p> <p><i>Sa më lart GVJ rekomandon,</i> pasurimin e bibliotekës me botime që janë drejtpërdrejt të lidhura me lëndët e planit mësimor.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, biblioteka elektronike “QUESTIA”, ka rreth 83,000 libra akademike dhe mbi 10 milionë artikuj shkencorë, e cila është në funksion të programit të studimit dhe është e aksesueshme pa pagesë.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës ku zakonisht shkojnë studentët dhe stafi akademik i këtij programi evidentoi se biblioteka ishte e pajisur me kompjutera dhe akses në internet.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në takimet me përgjegjësen e departamentit dhe punonjësen e bibliotekës, na u konfirmua se institucioni planifikon çdo vit fond të veçantë për blerjen e literaturës në shërbim të programit të studimit</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë, na u konfirmua se ajo është në dispozicion të studentëve nga ora 08.00 deri në orën 16:00. Orari gjendej i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.5




Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Administrimi i informacionit që lidhet me studentët realizohet nga sekretaria mësimore e programit të studimit, kryesekretaria e fakultetit si dhe administratori i përgjithshëm. Kjo u vërtetua edhe në takimin që realizuam gjatë vizitës në institucion me punonjëset e sekretarisë, kryesekretaren dhe administratoren e përgjithshme. Aty u prezantua me regjistrin themeltar dhe dokumente të tjera që lidheshin me aktivitetin e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në fazën e diplomimit.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësuesen e zyrës së burimeve njerëzore, u informuam se aty gjendeshin të dhënat dhe aktivitetet e stafit akademik, përfshirë kualifikimet shkencore, kontrata e punës, etj. Aty u njohëm gjithashtu me dosjet e stafit të angazhuar në programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit zhvillohet fizikisht dhe me anë të adresave të emailit të institucionit.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për</p>	<p>Të dhënat mbi stafin janë të aksesueshme në zyrën e burimeve njerëzore dhe ato përditësohen vazhdimisht në varësi të kualifikimeve dhe aktiviteteve të ndryshme akademike.</p>




organet drejtuese dhe titullarët.				
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacione që lidhen me programin e studimit Bachelor në anglisht, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në shqip dhe anglisht. Kjo u vërtetua pas kontrollit të faqes së internetit: https://albanianuniversity.edu.al/en/faculty-of-social-sciences-2/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në takimet e zhvilluara në institucion u deklarua se universiteti harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Plani i financimit të programit të studimit përfshihet brenda kuadrit të përgjithshëm të financimit të veprimtarive të institucionit. Nuk kemi evidentuar një plan specifik për financimin e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze.

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas deklarimeve gjatë vizitës në institucion, universiteti kryen audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në takimin e zhvilluar me administratoren e institucionit u informuam se në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë takimit të zhvilluar me administratoren e institucionit, na u konfirmua se garantohet qëndrueshmëria financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit por nuk disponojmë një dokument lidhur me këtë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Anglisht [evidenca 17] përcakton kriteret e pranimit deri në diplomimin e studentëve.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e regjistrimeve dhe transferimeve [evidenca 19] dhe rregullorja e programit të studimit Bachelor në Anglisht [evidenca 17] përcaktojnë kriteret dhe procedura të qarta për kandidatët dhe studentët që ndjekin programin e studimit.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Gjatë takimit të zhvilluar me studentët, konstatoam se informacioni lidhur me programin e studimit, që nga procedurat e pranimit e në vazhdim, ishte i qartë. Një rol i rëndësishëm në këtë drejtim luhej nga “Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve” si dhe “Zyra e Karrierës dhe Alumnit”. Duhet përmendur edhe ekzistenca e rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve [evidenca 19], e cila shpjegon qartë procedurat e nevojshme për realizimin e regjistrimeve dhe transferimeve.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Sipas RVB, kriteret e pranimit të studentëve publikohen në faqen zyrtare të “Albanian University” si dhe në të gjitha rrjetet sociale që menaxhon institucioni.
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë	Sipas RVB, pranimi i studentëve në programin e studimit realizohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

<p>përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Ndonëse kriter hyrës për regjistrimin e studentëve është mesatarja minimale e përcaktuar me VKM, programi i studimit ka të përcaktuar edhe kriteret e mëposhtme të pranimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 70% mesatarja sipas VKM - 30% mesatarja e lëndëve të cilat përcaktohen çdo fillim viti me Vendim të Senatit Akademik të AU, pas kërkesës së MASR. 			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Sipas deklarimeve të përgjegjëses së Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes dhe konstatimeve në RVB, zyra e regjistrimit dhe transferimit të studimeve organizon me maturantë të shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë takime informuese lidhur me programin e studimit. Në këto takime jepet informacion lidhur me kriteret e pranimit në programin e studimit si jepet një përshkrim i tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara në institucion me studentët, personelin akademik dhe përgjegjësen e departamentit, u informuam se në javën e parë të vitit akademik, institucioni organizon me studentët, stafin akademik dhe ndihmës akademik javën orientuese, në të cilën studentët informohen mbi aspektet e ndryshme të programit të studimit, përfshirë planin mësimor, programet lëndore, mënyrën e vlerësimit, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Rregjistrimeve dhe Transferimeve [evidenca 20], institucioni realizon transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të parë, në programe të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private apo publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në institucione të tjera të arsimit të lartë. Sipas RVB dhe nga takimi i realizuar me personelin akademik, konstatuam se studentët e programit informohen lidhur procedurat përkatëse.</p>




Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimi i realizuar me studentët në institucion, konstatuam se ata informohen lidhur me kriteret e vlerësimit të dijeve të tyre në fillim të vitit akademik nga pedagogu i lëndës.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët njihen me manualin e punimit të temës së diplomës [evidenca 43] dhe në takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët u informuam se këta të fundit njiheshin nga pedagogët përkatës me kriteret dhe procedurat e diplomimit.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në takimet e zhvilluara me përgjegjësen e departamentit, personelin akademik dhe studentët, u informuam se në javën e parë të fillimit të vitit akademik, institucioni organizon një javë orientuese, në të cilët studentët qartësohen mbi objektivat dhe elementet e tjera të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Siç u theksua edhe në standardin më lart, në javën e parë të vitit akademik, institucioni organizon me studentët, stafin akademik dhe ndihmës akademik javën orientuese, në të cilën studentët informohen mbi aspektet e ndryshme të programit të studimit, përfshirë planin mësimor, programet lëndore, mënyrën e vlerësimit, etj. Ky fakt u evidentua edhe nga takimet e zhvilluara në institucion me studentët.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe	Sipas RVB dhe takimeve të zhvilluara në institucion, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve organizon në javën e parë mësimore orë të hapura, ku studentët njihen me planin mësimor dhe veprimtaritë në shërbim të programit të studimit. Kjo

dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	zyrë vë në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Nga takimi me studentët konstatuam se ata informohen lidhur me mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Sipas RVB, informacion mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij gjendet në faqen zyrtare të institucionit dhe në programet e lëndëve.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Sipas deklarimeve gjatë takimeve në institucion dhe RVB, informacione në lidhje me programin e studimit sigurohen nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, rrjeteve sociale dhe komunikimit me email.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Në takimin e zhvilluar me punonjëset e sekretarisë mësimore në shërbim të programit të studimit, kryesekretaren e fakultetit dhe administratoren, u informuam se ato administrojnë të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Sekretaria na vuri gjithashtu në dispozicion regjistrin themeltar të notave.

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konfirmua se sekretaria mësimore, kryesekretaria e fakultetit si dhe administratori i përgjithshëm arkivon dhe mban në dosje dokumentet e çdo studenti që është i regjistruar, është i ç’regjistruar si dhe të studentëve që kanë përfunduar studimet e tyre.</p> <p>Sipas (<i>evidencës 3_Tabela_ nr.21</i>) dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <p>Viti 2017-2018 30 studentë gjithsej, nga ku 7 të transferuar; Viti 2018-2019 15 studentë gjithsej, nga ku 5 të transferuar; Viti 2019-2020 10 studentë gjithsej, nga ku 5 të transferuar;</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Siç u theksua edhe më lart, gjatë takimit në sekretarinë mësimore, konstatuam se ato menaxhonin të dhënat e ecurisë së studentëve përgjatë gjithë procesit, nga regjistrimi deri në diplomim.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sipas RVB, por edhe nga informacioni i marrë gjatë takimit me studentët, rezultatet e studentëve janë të disponueshme në llogarinë individuale të tyre në sekretarinë online, ku ata kanë akses.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Gjatë takimeve me punonjëset e sekretarisë mësimore, si dhe me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, konstatuam se ata mbanin të dhëna lidhur me profilet e studentëve të ardhur dhe aktualë dhe shkallën e punësimit të tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5




Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në bazë të statutit të institucionit [evidenca 10], studentët përfaqësohen në organet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik - Këshillin studentor - Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin - Komisioni për Vlerësimin Institucional - Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfaqësimi i studentëve në organet e renditura më sipër garantohet nga statuti i “Albanian University”. Gjithashtu, gjatë takimit të zhvilluar me studentët, u deklarua nga ana e tyre se përfaqësimi i tyre në organet e ndryshme të institucionit kishte efekte positive në proceset e vendimmarrjes që lidheshin me ta.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas planit mësimor [evidenca 16], programi i studimit Bachelor në “Anglisht” është i shtrirë në 3 vite akademike (6 semestra). Në dy vitet e para (4 semestra) studentët kanë nga 4 lëndë në semestër pra 8 lëndë në të gjithë vitin akademik. Në vitin e tretë, ka 7 lëndë (4 semestri i parë dhe 3 semestri i dytë).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional dhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. Në këtë mënyrë, ata bëhen pjesën e vendimarrjeve në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit.</p>




<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizon dhe zhvillon një pyetësor me studentët e programit të studimit [44], i cili mundëson vlerësimin dhe matjen e performancës së stafit akademik dhe atij administrativ.</p> <p>Duhet vënë gjithashtu më dukje realizimi i fokus grupeve nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ku pas një përzgjedhje të një numri të caktuar studentësh, u drejtohen pyetje lidhur me procesim mësimor, metodat e mësimdhënies të përdorura nga pedagogët, komunikimin me pedagogët dhe stafin administrativ. Për shembull, studentët e programit të studimit në fjalë kanë kërkuar rishikim të programit të lëndës së frëngjishtes. [45]</p> <p>Në rastet kur një student nuk është i qartë nga sqarimi me pedagogun e lëndës atëherë ngrihet komisioni për rivlerësimin e tezës. E gjithë procedura mbi ankimimin e provimit dokumentohet dhe ruhet në arkivat e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. Megjithatë, nga takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët, rezultoi se nuk kishte pasur asnjë ankesë lidhur me vlerësimin e pedagogëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Informimi i studentëve realizohet nga zyra e regjistrimeve dhe ekuivalentimeve. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët, u vlerësua nga ana e tyre java e parë orientuese për informimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e</p>	<p>Në shërbim të studentëve të programit të studimit, funksionon Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentëve, e cila është përgjegjëse për krijimin e programit të mentorimit në mbështetje të orientimit profesional të studentëve.</p>




tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.									
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në shërbim të këshillimit të karrierës funksionon Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, e cila siguron realizimin e programit të mentorimit për studentët. Ky program i siguron atyre informacion lidhur me aspektet profesionale Gjithashtu, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit ku ata do të realizojnë praktikën mësimore.								
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjatë takimit me përfaqësuesin e Zyrës së Zhvillimit të Karrierës dhe Alumnit, na u konfirmua se ekzistojnë të dhëna statistikore për të gjithë të diplomuarit, si dhe informacion lidhur me punësimin e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në Anglisht.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Albanian University ka një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nëpërmjet Komisionit të përhershëm institucional për sigurimin e cilësisë [69] dhe Zyrës së Sigurimit të brendshëm të cilësisë [68]. Të dyja strukturat hartojnë politika, mekanizma dhe ndjekin procedura në përputhje me Strategjinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të miratuar në nivel insitucional [71]. Kjo e fundit përcakton edhe politikat e sigurimit të cilësisë në kuadër të zhvillimit të programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Zyra e Sigurimit të brendshëm të cilësisë funksionon në nivel institucional. Pranë saj janë atashuar dy ekspertë të jashtëm: një konsulent juridik [72] dhe një konsulent për çështjet e zhvillimit dhe përmirësimin të kurrikulave [73]. Ajo ka rregulloren e saj dhe zbaton mekanizmat e përmirësimin të cilësisë, të përcaktuara në nenet 9 dhe 10.</p> <p>Në rastet e akreditimit të progameve të studimit, kjo njësi bashkërendon punën me NJSBC në nivel departamenti [70] dhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. Kjo e fundit ndjek sigurimin e brendshëm të cilësisë në kurrikula dhe sillabuse lëndore çdo vit akademik [73, neni 7/Tak.1/ Tak.4].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Njësia gjithashtu harton Raportin e sigurimit të brendshëm të cilësisë të cilin e paraqet për miratim në Komisionin e përhershëm të sigurimit të cilësisë dhe në Senatit akademik [75].</p> <p>Kuadri ligjor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel insitucional është i mirëorganizuar.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Programet e ciklit të parë janë objekt monitorimi i Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe NJSBC-së [76, neni 6]. Këto struktura përfshihen në rastet e sigurimit të cilësisë në programet lëndore dhe ndryshimet në kurrikul, ndërkohë që monitorimi i cilësisë në mësimdhënie kryhet me anë të mekanizmave të tillë si: pyetësorë, sondazhe, fokus grupe, dëgjime në auditor, etj [76, neni 7].
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Programi është gjithashtu objekt i monitorimit të cilësisë me anë raporteve vjetore të vetvlerësimit në të cilat shqyrtohet veprimet e ndërmarra nga plan-veprimi i vitit paraardhës, plan-veprimi i vitit në vazhdim, feedback-u i studentëve, feedback-u i mbledhur nga personeli akademik, statistika të regjistrimeve, të kalueshmërisë, të alumni dhe praktikant e mira në nivel programi [75]
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Mbarëvajtja e kurrikulës është gjithashtu projekt monitorimi i Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, e cila vepron nën Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, i përbërë nga 5 anëtarë, ndër të cilët një student [74, neni 4]. Zyra ka përgjegjësinë e monitorimit të proceseve të hapjes dhe ristrukturimit të programeve dhe kontrollit të vazhdueshëm të cilësisë në cilësinë e stafit, feedback-un e studentëve dhe nevojat e tregut.
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Gjetjet e raportimeve të mësipërme paraqiten në Komisionet e përhershme përkatëse dhe i përcillen Senatit Akademik. Raportet vjetore të veprmtarisë në të cilat përfshihet edhe sigurimi i cilësisë së programeve të studimit përcillen në MAS [53].
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Në referencë të përshkrimit të Standardit VI.2 të këtij raporti, mund të thuhet se DEA menaxhon cilësinë e programit që ofron me anë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - hartimit të Raportit vjetor të veprimtarisë së saj; - hartimit të Relacionit për vlerësimin e përvitshëm të programeve të studimit; - kordinimit që kryen me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës dhe atë të Sigurimit të Cilësisë në rang institucional; <p>Njësia gjithashtu monitoron cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të stafit akademik në mënyrë periodike me anë të plotësimit dhe Raporteve semestrale që titullarët e lëndëve plotësojnë për mbarëvajtjen e veprimtarisë së lëndës/modulit në përfundim të saj [50/ 53].</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit bën gjithashtu një vlerësim të performancës së stafit akademik [47/ Tak.1/ Tak. 4].</p> <p>Mendimi i studentëve mbledhet me anë të pyetësorëve mbi cilësinë e mësimdhënies së pedagogut, mbi vlerësimin e lëndës dhe modulit dhe mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara nga sturktrat administrative në funksion të mësimdhënies [44/86/87/88]. Studentët janë gjithashtu të përfshirë në intervista me fokus-grupe të organizuara në nivel institucional. Kjo praktikë synon zgjedhjen rastësore të studentëve të ndryshëm aktivë në secilin program dhe marrjen e mendimit të tyre në lidhje me mbarëvajtjen e veprimtarisë së programit të studimit që ndjekin. Fokus-grupet reflektojnë edhe probleme ku duhen ndërhyrë. [45/ Tak.1]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime</p>	<p>NJBSC në nivel institucional gjithashtu organizon trajnime me stafin akademik në lidhje me elementë të caktuar të sigurimit të</p>

<p>ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>cilësisë [48/ Tak. 5], ose në lidhje me rritjen e performances mësimdhënëse në auditor [49/Tak.1/ Tak.4/ Tak.2].</p> <p>Të tjera mekanizma të përdorura nga DEA për mbarëvajtjen e programit të studimit janë edhe vlerësimet e drejtëpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik/studentëve kur vlerësohet si e domosdoshme [53].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në vijim të sa më sipër mund të thuhet se kuadri ligjor institucional i sigurimit të brendshëm të cilësisë në këtë program studimi është i përcaktuar dhe mirëpërkufizuar. Ai definon procedurat, mekanizmat dhe aktorët kryesorë që përfshihen në proces.</p> <p>Dokumentacioni i paraqitur në lidhje me reflektimin e sa më sipër në dosjen që shoqëron RVB të këtij programi është dokumentacion standard; me fjalë të tjera shembuj të paplotësuar të formularëve, raporteve dhe pyetësorëve, ose shkresa/vendime të miratimit të krijimit të strukturave të sigurimit të cilësisë, të</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe</p>	

<p>detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>ekspertëve të jashtëm të matjes së saj dhe të kuadrit ligjor rregullator të këtij procesi.</p> <p>Nuk është paraqitur asnjë raport analitik i tyre dhe aq më pak një plan veprimi që të pasojë gjetjet e kësaj analize. I vetmi dokument që pasqyron një përshkrim të mekanizmave të sipërpërmendur të cilësisë është Raporti i veprimtarisë vjetore [53], edhe në të cilin sa më sipër ka karakter deskriptiv dhe konstatues. Në shembullin e paraqitur gjetjet kanë qenë kryesisht pozitive dhe shumë pranë pritshmërive të njësisë. Kjo lë të kuptohet që njësia nuk ka pasur nevojë të ndërmarrë masa në lidhje me përmirësimin e problemeve të kontatuara.</p> <p>Për më tepër, në intervistat e zhvilluara me grupet e interesit gjatë vizitës në institucion, shembujt e sjellë në lidhje me sigurimin e cilësisë ishin thuajse të njëjtë, gjë që lë të kuptohet se ky proces nuk është një kulturë e vazhdueshme e njësisë që të sigurojë vijimësinë e procesit nga viti në viti dhe përfshirjen më të madhe dhe më të përgjegjshme të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon</i> që departamenti duhet të krijojë një kulturë e vazhdueshme e njësisë së vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në mënyrë që të sigurojë vijimësinë e procesit nga viti në viti dhe përfshirjen më të madhe dhe më të përgjegjshme të stafit akademik dhe studentëve; plan-kalendari i veprimtarive të saj do të ishte një nisje e mirë.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>				
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi VI.5




Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Institucioni koordinon veprimtarinë e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të cilësisë në nivel insitucional, sipas njësive dhe aktorëve të përfshirë në të.</p> <p>Raportet e saj parqiten për miratim në organet përkatëse dhe gjetjet e tyre përcillen në njësitë kryesore për përvijimin e mëtejshëm të punës [45].</p> <p>Institucioni gjithashtu përcjell në ministrinë përkatëse Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe e publikon atë në faqen e vet zytare https://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2019/10/RAPORT-VJETOR-18-19-MASR.pdf</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar arine dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni gjithashtu publikon parime të sigurimit të brendshëm të cilësisë në rang insitucional dhe raporte të vlerësimit të jashtëm po ashtu insitucional. Përditësimi i tyre në faqen e internetit nuk është i rregullt. https://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2019/06/Raport-Vler%C3%ABsimi-ZSBC-2015-2016-AU.pdf</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Elementët e tjerë që lidhen me aktivitetet dhe procedurat që ndjekin relacionet e sigurimit të cilësisë janë shpjeguar në reference të Standardit VI.4</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




			X	
--	--	--	---	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Anglisht”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Departamenti ka staf të qendrushëm e të kualifikuar në fushat e studimit që ofron programi. *(Standardi II.2)*
2. Kushtet e mjediseve mësimore janë të kënaqshme *(Standardi IV.3)*
3. Kuadri ligjor institucional i sigurimit të brendshëm të cilësisë në këtë program studimi është i përcaktuar dhe mirëpërkufizuar. Ai definon procedurat, mekanizmat dhe aktorët kryesorë që përfshihen në proces. *(Standardi IV.4)*

b. Pika të dobta:

1. Departamenti nuk ka të përcaktuara qartë objektivat përcaktuese dhe specifike të programit të studimit dhe kompetencat që ai i ofron të diplomuarit. *(Standardi I.3 Kriteri 1)*
2. Departamenti ka një kuadër minimal/modest marrëveshesh me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë. *(Standardi I.5, Kriteri 3)*
3. Kurrikula ka një prirje të ndjeshme ndaj formimit të mësuesve të gjuhës angleze, ndërkohë që ky kualifikim i përket programeve të ciklit II, sipas legjislacionit në fuqi. *(Standardi I.3, kriteri 3) (Standardi II.1, kriteri 2/4) (Standardi II.4)*
4. Biblioteka fizike duhet pasuruar me literaturë bazë në shërbim të programit të studimit *(Standardi III.3)*

Rekomandime:

1. Rregullorja e programit të studimit duhet të përcaktojë qartë fushat e formimit akademik që synon të ofrojë me anë të kurrikulës; kompetencat/rezultatet e të nxënit; fushat e kërkimit shkencor aplikativ (për një program të ciklit të parë); kuadrin e studimeve të ciklit të dytë për të cilat ai i kualifikon studentët e diplomuar;

2. Rregullorja e studimit duhet të përmbledhë gjithashtu njohuritë/ rezultatet e të nxënit që ofrojnë kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese, me qëllim specifikimin e objektivave formuese të programit të studimit;
3. Departamenti ka nevojë të zgjerojë kuadrin e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë, për të rritur mundësitë e mobilitetit të stafit dhe studenteve, përditësimin të infrastrukturës dhe rritjes së kapaciteteve në programin në fjalë;
4. Njësia duhet të ndryshojë statusin dhe ngarkesën e lëndëve të formimit psiko-pedagogjik në kurrikul, në mënyrë që të shmangë mundësinë e përsëritjes së këtyre njohurive nga një student që zgjedh të ndjekë ciklin e dytë në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze dhe në mënyrë që t'u lërë më tepër hapësirë lëndëve/moduleve që ofrojnë njohuri më specifike të formimit gjuhësor, kulturor, stilistikor dhe analitik të gjuhës angleze;
5. Njësia duhet të rishikojë raportin teori/praktikë në lëndët me karakter praktik të listuara në Standardin II.4, kriteri 2;
6. Departamenti duhet të ristrukturojë kurrikulën me qëllim përshtatjen me rekomandimet e përshkruara në Standardin II.4 dhe Standardin II.1, në vijim të një studimi më të gjerë të tregut të punës që shkon përtej analizës së gjendjes në institucione arsimore;
7. Departamenti/ Fakulteti duhet të përditësojë funksionet e laboratorit të TIK me qëllim përdorimin e tij efikas në profiling e gjuhëve të huaja;
8. Biblioteka fizike duhet pasuruar me literaturë bazë në shërbim të programit të studimit;
9. Departamenti duhet të krijojë një kulturë e vazhdueshme e njësisë së vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në mënyrë që të sigurojë vijimësinë e procesit nga viti në viti dhe përfshirjen më të madhe dhe më të përgjegjshme të stafit akademik dhe studentëve; plan-kalendari i veprimtarive të saj do të ishte një nisje e mire;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in “English”

a. Strengths and affirmations:

1. The Department of English Language reflects full-time staff stability and proper qualifications in the academic domains offered by the programme. (*Standard II.2*);
2. The teaching and learning infrastructure is satisfactory (*Standard IV.3*);
3. The institutional legal frame on quality assurance is well-defined in terms of procedures, mechanisms and stakeholders involved in the QA processes. (*Standard IV.4*);

b. Weaknesses:




1. There is no clear outline of the general and specific objectives of the study programme, neither of its learning outcomes. (*Standard I.3 Crit. 1*);
2. The Department displays only a modest/minimal corpus of agreements with international higher education institutions. (*Standard I.5, Crit. 3*);
3. The curriculum obviously inclines to the qualification of teachers of English language, while the legal frame in Albania clearly sets this qualification is to be earned during the second cycle. (*Standard I.3, Crit. 3*) (*Standard II.1, Crit. 2/4*) (*Standard II.4*);
4. The corpus of hardcopy books available to the staff and students of this study programme at the AU library is poor and out-dated. (*Standard III.3*);

Recommendations:

1. The regulation of the study programme should outline the academic domains and qualifications offered by the curriculum, competences and learning outcomes, applicative research (proper for a first cycle study programme), as well as the frame of further second cycle studies for which it prepares its graduates;
2. The regulation of the programme should also include the set of knowledge and learning outcomes offered by the composing courses and modules (according to their categorization as elements of the study programme) with the aim of specifying its overall qualification objectives;
3. The Department needs to enlarge and diversify the range of the cooperation agreements with international higher education institutions, in order to increase mobility opportunities for its staff and students, to improve available academic infrastructure and to enhance capacity building of the academic offer;
4. The Department needs to change the status and the workload of the courses of a psychopedagogical character, in order to avoid possible repetition of knowledge when the student pursues studies in a second cycle study programme to become a teacher of English language. This would provide much more useful space in the curriculum for courses that offer specific knowledge on the linguistic, cultural, stylistic and analytical acquisition of English language;
5. The Department should also review the ratio theory/practice in the courses of a very practical character, listed in Standard II.4, Crit. 2;
6. The Department should undertake a curriculum reorganization to adopt it with the recommendations of Standard II.4 and Standard II.1, following proper job market research whose focus is not merely on educational institutions;
7. The Department/Faculty should upgrade the function and the services offered by the Foreign Language Laboratory, to enlarge its scope of use for a foreign language learning profile;
8. The AU Library needs to be enriched with hardcopy and/or electronic literature available to students and staff of this study programme;



9. The Department needs to have “a culture” of its own inner quality assurance, so as to ensure continuity of the process and larger and more responsible involvement of the academic staff and students; designing a Department IQA agenda would be a good first step in this respect;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	


